



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 41

Prishtinë, më 05.04.2016 në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Slobodan Petrović, Xhavit Haliti, Luljeta Veselaj -Gutaj, Bislim Zogaj, Vjosa Osmani dhe Arben Gashi .

Munguan: Valdete Bajrami, Ilir Deda, Time Kadrijaj dhe Kujtim Paçaku.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi kryetarja e Komisionit, znj. Teuta Sahatqija,

Në mbledhje u propozua ky;

Rend i ditës:

Kryetarja e Komisionit , pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, hapi mbledhjen.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 01.03.2016 dhe 24.03.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 01.03.2016 dhe 24.03.2016;

Procesverbalet nga mbledhjet e datës 01.03.2016 dhe 24.03.2016 u miratuan pa ndryshime .

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja tha se Projektligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës ka qenë në shqyrtim edhe ne mandatin e kaluar dhe Komisioni për Integritet Evropian ka pas bashkëpunim me Zyrën e BE-së në Kosovë.

Në vazhdim prezantoj opinionin ligjor të këtij projektligji .

Projektligji përmban gjithsej 33 nene dhe 17 amendamente të komisionit funksional.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian, përkatësisht Kapitulli 32 e Acquis të BE-së mbulon fushën e kontrollit financiar. Ky kapitull ka të bëjë me aprovimin e parimeve të cilat janë të pranuar ndërkombëtare dhe në përputhje me BE-në. Pra mbështet një strukturë operacionale dhe financiarisht të pavarur të auditorit të jashtëm me qëllim të vlerësimit të cilësisë së kontrollit të brendshëm të financave publike.

Pas shqyrtimit u konstatua se Projektligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditorit të Republikës së Kosovës, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, pasi që në mënyrë të konsiderueshme ka përfshirë parimet e përgjithshme të auditorit sipas standardeve ndërkombëtare, dhe nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Andaj lidhur me këtë projektligj hapi debatin.

Vjosa Osmani theksoi se ky projektligj ne mandatin e kaluar ka qenë një ndër projektligjet që ka pas përplasje më të madhe ne mes te Komisionit për Integritet Evropian dhe Komisionit funksional, sepse ka pas tendenca që në disa prej neneve te hartuara që auditori i përgjithshëm mos te siguroj pavarësinë e plotë institucionale. Komisioni për Integritet Evropian ka pas insistuar që Auditori i përgjithshëm te ketë jo vetëm pavarësi financiare por edhe operacionale dhe kemi pas diskutime te gjata edhe për mënyrën e strukturimit te këtij institucioni. Tani jemi informuar nga stafi se vërejtjet nga mandati i kaluar janë marr parasysh në mënyrë që ky ligj të jetë në përputhshmëri te plot me ato standarde dhe parimet themelor te pavarësisë së funksionimit, përfshirë dhe pavarësimin institucional dhe ky është një lajm i mirë jo vetëm ne aspektin ekonomik por edhe për procesin e integriteteve.

Pas diskutimeve kryetarja konstaton se komisioni një zëri nxori këtë;

Rekomandim

Projektligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës së bashku me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së , përkatësisht me Acquis të BE-së ,mund te rekomandohet për miratim ne procedurë te rregullt ne Kuvend.

4.Të ndryshme

Kryetarja pyeti anëtarët e Komisionit se a ka ndonjë çështje për diskutim.

Pasi nuk u paraqit askush për diskutim, kryetarja e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 10:15.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Znj. Teuta Sahatqija
